



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
KOMISIONI I SISTEMIT DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 31.08.2023

Formulari Nr.3

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Enti Rregullator i Energjisë
Adresa Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, Tiranë
Tel/Fax 0692223665
E-mail aqerimi@ere.gov.al
Faqja e Internetit www.ere.gov.al

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: Blerje 1 (një) biletë avioni me destinacion Tiranë – Athinë - Tiranë.

Data e zhvillimit do të jetë **01.09.2023, ora 09:00** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Blerje bileta avioni me destinacion Tiranë – Athinë – Tiranë në datat 05.09.2023 – 07.09.2023	1

Biletat e avionit me destinacion Tiranë - Athinë - Tiranë, të jenë vajtje – ardhje:

Nisja në datë 05 shtator 2023 nga Tirana, të bëhet mbasdite (ora 17:10) fluturim direkt.

Kthimi nga Athina për në Tiranë në datë 07 shtator 2023, të bëhet mbasdite (ora 16:10) fluturim direkt nga Athina.

Biletat të jenë të klasit ekonomik, përfshirë dhe bagazhin 20 kg.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentet si më poshtë:

- a- Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;
- b- Operatori ekonomik duhet të jetë i akredituar nga International Air Transport Association (IATA). Për të vërtetuar këtë kërkesë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatën e akreditimit ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association (IATA), të vlefshme.
- c- Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në këtë fushë, gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e akreditimit IATA 3 (tre) viteve të fundit ose një vërtetim lëshuar nga IATA që deklaron gjendjen e akreditimit për 3 (tre) vitet e fundit.
- d- Operatori ekonomik me anë të një vetë deklarimi, duhet të marrë përsipër se:
 - Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.
 - Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.

Afati i dorëzimit të dokumentave: do të jetë brenda 2 orëve nga momenti i dërgimit të njoftimit. Operatori i renditur i pari duhet të njoftojë autoritetin kontraktor, brenda 2 orëve mbi pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Në njoftim duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**KRYETARI
PETRIT AHMETI**